

**Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete
Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik**

QENDRAT PËR PUNË SOCIALE NË PROCEDURAT CIVILE

Edicioni 2

Mars 2010

Qendrat për Punë Sociale në procedurat civile

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovës (OSBE) është e brengosur se dështimi i gjykatave për të kërkuar këshilla të ekspertëve nga Qendra për Punë Sociale (QPS) në rastet ku ekspertiza e tyre është qenësore dhe e kërkuar me ligj, mund të shkel kornizën ligjore të Kosovës si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ngjashëm, OSBE është e brengosur edhe me dështimet sporadike të QPS-së për t'u përgjigjur brenda kohës së arsyeshme kërkesave të gjykatës për këshillë të ekspertit.

Përpos shkeljes së mundshme të kornizës ligjore, kjo praktikë ndikon po ashtu negativisht në ushtrimin e të drejtës së palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme sipas Nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNj).

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF), jep mandat që interesat më të mira të fëmijës të merren parasysh si pikë primare në të gjitha procedurat gjyqësore ku përfshihen fëmijët.¹ Veç kësaj, në të gjitha procedurat gjyqësore që prekin fëmijët, atyre duhet ti jepet mundësia që të dëgjohen, qoftë drejtpërdrejtë qoftë përmes një përfaqësuesi apo një organi të përshtatshëm.²

Korniza ligjore e Kosovës adreson këto kërkesa normative ligjore pjesërisht përmes ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare,³ i cili kërkon që çdo komunë në Kosovë të krijojë dhe mirëmbajë një QPS.⁴ QPS është një institucion publik "me personel nga profesionistë të trajnuar në mënyrë të përshtatshme dhe të kualifikuar (zyrtarë të shërbimit social)," të cilët janë përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me ligj dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.⁵ Për më tepër, QPS funksionon si organ

¹ Neni 3 (1) parashikon se "[N] të gjitha veprimet lidhur me fëmijët, të ndërmarra nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesat më të mirë të fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore."

² Neni 12, KDF. Teksti i plotë i KDF është në dispozicion në: <http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm> Më tej, viktimat fëmijë duhet të kenë qasje në ndihmë efektive nga profesionistët të cilët kanë marrë trajnimin përkatës. Shih *Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi Drejtësinë në Çështjet që përfshijnë Viktimat Fëmijë dhe Dëshmitarët e Krimin*, në ECOSOC Rezoluta 2005/20, 22 korrik 2005 paragrafi 22 *et sequentes*.

³ Neni 9.1. Ky ligj kërkon që interesi më i mirë i fëmijës të jetë "konsideratë e dorës së parë dhe kryesore" në "të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe për familje." Ligji Nr.02/L-17, mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr 2005 / 46 me 14 tetor 2005, (këtej e tutje, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare).

⁴ Neni 7.1, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

⁵ Neni 7.1 dhe Neni 2, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare. Neni 1.3, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare përcakton organin e kujdestarisë si "funksion brenda Qendrës për Punë Sociale, përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve." Teksti në gjuhën shqipe i referohet organit të kujdestarisë si "organ i kujdestarisë", një frazë e cila është përkthyer në "autoriteti i kujdestarisë" dhe "organi kujdestar", me sa duket në mënyrë të shkëmbyeshme brenda kuadrit ligjor të Kosovës. Neni 6, i Ligjit nr 2004/32, Ligji mbi Familjen i Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/7 (këtej e tutje Ligji mbi Familjen) thotë: "(1) mbrojtja dhe ndihma për familjen do të rregullohet nga organi kompetent i administratës komunale i cili është përgjegjës për çështjet e ndihmës sociale. (2) Organi kujdestar është një organ komunal administrativ kompetent për çështje sociale. Ai do të përbëhet nga një grup i ekspertëve me përvojë pune profesionale në fusha specifike të detyrës. (3) Organi kujdestar mund të jetë një organ (grup i ekspertëve siç u përmend më lart) e

kujdestarie dhe kryen detyrat e kërkuara për këtë funksion siç përcaktohet në ligjet përkatëse të Kosovës.⁶ Në rastet e parapara me ligjet përkatëse, QPS-të duhet po ashtu të japin këshilla të ekspertëve pranë gjykatave sipas kërkesës.⁷

Korniza ligjore e Kosovës parasheh lloje të caktuara të procedurave civile në të cilat gjykata duhet të kërkojë këshilla të ekspertëve nga QPS-të përkatëse.⁸ Në këto raste gjykata kërkon nga QPS-të për të “kryer hetime dhe për të dhënë një vlerësim të ekspertëve në lidhje me rrethanat sociale të personit në fjalë dhe të bëjë rekomandime lidhur me mirëqenien e tyre në të ardhmen.”⁹ Nën kushte të veçanta të parapara me ligj, gjykata mund të kërkojë nga QPS-ja për të kryer procedurën e pajtimit të bashkëshortëve në kontestet martesore.¹⁰ Në secilin rast, QPS-ja duhet të paraqesë një raport pranë gjykatës.¹¹ Për më tepër, sipas ligjit, në rastin për të cilin ky raport (këshilla të ekspertëve) është kërkuar nga QPS, gjykata nuk mund të marrë një vendim përfundimtar pa e marrë parasysh përmbajtjen dhe rekomandimet e tij.¹²

Pavarësisht nga detyrimet e qarta të QPS-së sipas kornizës ligjore të Kosovës si dhe ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut,¹³ OSBE ka monitoruar raste në të cilat përfshiheshin të miturit ku QPS-të kanë dështuar të veprojnë për të mbrojtur interesat më të mirë të fëmijës. OSBE-ja ka raportuar më parë lidhur me rolin dhe punën e QPS-së në procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit, duke nënvizuar rastet e dhunës familjare ku gjykatat dështuan të thërrasin një përfaqësues nga QPS, ose një përfaqësues i QPS-së i ftuar në mënyrë të rregullt nuk u paraqit në seancë dëgjimore dhe gjykata megjithatë vazhdoi me procedurë.¹⁴

një institucioni të veçantë shoqëror , i cila është themeluar nga Kuvendi Komunal për të kryer obligime të tilla. [...]. ”

⁶ Neni 7.2, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare. Në detyrat specifike të QPS-së në lidhje me procedurën civile shih gjithashtu: Nenet 80-83, 140, 143, 148.3, 150-154, 161, të Ligjit mbi Familjen; Neni 7.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje; Nenet 73-78 dhe 82.2, Ligji Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Kosovës, 20 shtator 2008 (Ligji mbi Procedurën Kontestimore i vitit 2008) dhe Neni 4. 3(ndër të tjera) i Ligjit Nr.03/L-007 mbi Procedurën Jashtë-Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Kosovës, 20 shtator 2008.

⁷ Neni 14, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

⁸ Shih më lartë në fusnotën 6.

⁹ Neni 14.1, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

¹⁰ Neni 80, Ligji mbi Familjen.

¹¹ Neni 14.2, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Neni 83.2, Ligji mbi Familjen.

¹² Neni 14.3, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

¹³ Neni 9.5, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare kërkon nga Qendra për Punë Sociale, që në përmbushjen e përgjegjësisë të saj sipas Ligjit mbi të Miturit, si dhe në rolin e vet si organ kujdestarisë, të sigurojë që shërbimet të cilat i ofron në bazë të këtij mandati të jenë “[...] në përputhje me detyrimet e saj për fëmijët, siç janë të përcaktuara me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës. ”Shih gjithashtu nenin 12, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

¹⁴ Shih raportin mujor të Seksionit për Monitorimin e Sistemit Juridik, *Procedurat Gjyqësore ku përfshihen Rastet e Dhunës Familjare* (nëntor 2009); dhe “*Dëshimi i gjykatave për të përfshirë autoritetin kujdestar në procedurat e shkurorëzimit shkel ligjin e zbatueshëm*” (dhjetor 2005): shih po ashtu raportin publik “*Raport mbi Rastet e Dhunës Familjare në Kosovë*” (korrik 2007).

Roli dhe puna e QPS-ve

Kurdo që gjykata trajton procedurat civile ku përfshihen fëmijët, gjykata mund të kërkojë nga QPS-ja për të dhënë një vlerësim të ekspertit.¹⁵ QPS duhet të paraqesë raportin pranë gjykatës brenda 21 ditëve nga kërkesa, përveç nëse specifikohet ndryshe në kërkesë.¹⁶ QPS në kapacitetin e organit kujdestar që merr pjesë në procedurat e ligjit mbi familjen ka një rol më aktiv. Organi i kujdestarisë është i autorizuar për të paraqitur mocionet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe interesave, për të prezantuar dëshmi të cilat palët i kanë lënë jashtë, për të sugjeruar administrimin e provave të nevojshme, të ushtrorë mjetet juridike dhe të ndërmer veprime të tjera të diskutueshme. Gjkata është e detyruar të ftojë organin e kujdestarisë në të gjitha seancat gjyqësore, dhe ta shërbejë atë me të gjitha vendimet.¹⁷ Veç kësaj, në rastet e dhunës familjare kur shqyrtohet një kërkesë për urdhër mbrojtës, gjykata mund të dëgjojë përfaqësuesin e QPS-së kur parashtruesi i kërkesës është nën moshën 18 vjeçare, nëse veprimet e supozuara të dhunës ndikojnë në personat nën moshën 18 vjeçare, ose në qoftë se një personi i mungon zotësia juridik.¹⁸

OSBE-ja ka monitoruar raste kur QPS-të nuk u treguan të kujdesshme në kryerjen e rolit të tyre, si dhe rastet kur gjykata dështoi të kërkojë mendimin e ekspertit nga QPS-të ose pjesëmarrjen e tyre në procedurat civile, siç parashihet me ligj. Për shembull:

Me 17 shtator 2008, në një gjykatë në rajonin e Pejë/Peć, paditësja parashtroi një kërkesë me të cilën kërkonte kontakte me fëmijën e saj që ka lindur në një marrëdhënie jashtëmartesore. Me 21 tetor 2008, përmes një përgjigje me shkrim, i padituri i propozoi gjykatës që ajo të refuzojë kërkesën e paditëses si të pabazë, pasi fëmija nuk e njihte nënën e vet. Me 12 nëntor 2008, në seancë, gjykata kërkoi një raport të ekspertëve nga QPS. Një seancë dëgjimore ishte planifikuar për 14 janar 2009. Raporti i QPS-së arriti në gjykatë me 22 janar 2009, rreth një javë pas datës së seancës dëgjimore. Veç kësaj, gjykata ftoi dhe kërkoi praninë e përfaqësuesit të QPS-së në seancën e 14 janarit 2009. Përfaqësuesi i QPS-së nuk ishte i pranishëm në këtë seancë dhe gjykata nuk ka marrë asnjë justifikim nga QPS-ja për të shpjeguar arsyet mbi të cilat nuk i është përgjigjur kërkesës së gjykatës.

Në gusht 2009 në një gjykatë në rajonin e Prizrenit kishte filluar një rast i kujdestarisë së fëmijës që përfshinte palët që kishin dy fëmijë të mitur të lindur në marrëdhënie jashtëmartesore. Paditësja, nëna e fëmijëve, kishte iniciuar gjithashtu një procedurë për dhunë në familje për shkak të dhunës të dyshuar të vuajtur nga i padituri, babai i fëmijëve të saj. Gjatë procedurës, i padituri kishte ngritur çështje siç është shëndeti mendor i paditëses. Ligji mbi Familjen parasheh që në rastet kur prindërit nuk kanë arritur një marrëveshje në lidhje me kujdestarinë e fëmijës gjykata vendos pas dëgjimit të mendimit dhe të

¹⁵ Neni 14, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

¹⁶ Neni 14.2, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

¹⁷ Neni 6.4, Ligji mbi Familjen.

¹⁸ Neni 7.2 dhe 7.3, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje. Siç është diskutuar në raportin e vitit 2007 të OSBE-së “*Raport mbi Rastet e Dhunës Familjare në Kosovë*”, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 dështon në mandatimin e përfshirjes së QPS-së në procedura të tilla. Në vend të kësaj, ligji thotë se përfaqësuesi i QPS-së “mund të dëgjohej.”

propozimit të organit të kujdestarisë, si dhe pas hetimit të të gjitha rrethanave relevante të rastit.¹⁹ Megjithatë, gjatë tërë procesit nuk u zhvillua procedura e provave, dhe gjykata nuk i ftoi dhe as nuk kërkoi një mendim ekspertësh nga QPS-ja. Kjo është qartë në kundërshtim me kornizën ligjore të Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.²⁰ Ky është një shqetësim i veçantë kur kihet parasysh që palët bënë akuza të rënda duke përfshirë dhunën në familje si dhe çështje të shëndetit mendor të kujdestarëve potencial²¹ të fëmijëve. Po që se pohimet kanë mund të jenë të vërteta, kjo mund të ndikojë në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Sipas kornizës ligjore të Kosovës, në të dyja rastet, gjykata duhet të ketë dëgjuar mendimin dhe propozimin e organit të kujdestarisë dhe duhet të ketë hetuar të gjitha rrethanat përkatëse të rastit. Për më tepër, përfaqësuesi i QPS-së duhet të ketë qenë i pranishëm në seancat gjyqësore për të përfaqësuar ose për të dëshmuar lidhur me interesin më të mirë të fëmijëve dhe të bëjë rekomandime lidhur me mirëqenien e tyre në të ardhmen.

Vonesat në parashtrimin e vlerësimit të ekspertit nga ana e QPS-së

Në rastet në të cilat këshilla të ekspertëve kërkohen nga QPS-të, gjykata nuk mund të arrijë asnjë përfundim përdorisht nuk i ka marrë parasysh përmbajtjen dhe rekomandimet nga kjo këshillë e ekspertit.²² Prandaj ligji është specifik dhe parasheh se pas dorëzimit të kërkesës së gjykatës, drejtori i QPS-së duhet t'i urdhëroj zyrtarët e vet që të fillojnë hetimet në mënyrë që të sigurojë që gjykatës do ti jepet raporti i kërkuar jo më vonë se 21 ditë pasi që është bërë kërkesa, përveç nëse specifikohet ndryshe në kërkesë.²³ Megjithatë, afati shtyhet në rastet kur QPS-ja zhvillon procedurën e pajtimit në kontestet martesore. Ligji thotë se “procedurat e pajtimit para Organit të Kujdestarisë nuk mund të zgjasin më shumë se tre muaj, por mund të shtyhen në qoftë se bashkëshortët pajtohen [...]” dhe QPS-ja duhet që pa vonesë t’ia dorëzojë gjykatës raportin lidhur me rezultatin e procedurës së pajtimit.²⁴

¹⁹ Neni 140.2, Ligji mbi Familjen

²⁰ Neni 3.3 i KDF parasheh se autoritetet “do të sigurojnë që institucionet, shërbimet dhe objektet përgjegjës për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të përputhen me standardet e përcaktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushat e sigurisë, shëndetit, në numrin dhe përshtatshmërinë e personelit e tyre, si dhe në mbikëqyrje kompetente.”

²¹ Neni 236. Ligji mbi Familjen thotë që "(1) Personit nën kujdes, Organi i Kujdestarisë ia cakton kujdestarin. (2) Si kujdestar mund të jetë çdo person i cili ka cilësitë personale dhe aftësitë e nevojshme për përmbushjen e detyrave të kujdestarit dhe i cili më parë jep pëlqimin që të bëhet kujdestar. (3) Kujdestari në radhë të parë caktohet nga mesi i personave në familjen e personit nën kujdestari. Organi i Kujdestarisë do të vendosë nëse kjo gjë është në interes të të kujdesurit." Neni 244, Ligji për Familjen radhit detyrimet e kujdestarit" (1) Kujdestari posaçërisht është i detyruar që të kujdeset në mirëbesim për personalitetin dhe të drejtat dhe interesat e të kujdesurit, dhe të administrojë pasurinë e tij me kujdes, si dhe të informojë Organin e Kujdestarisë për drejtimin e kujdestarisë. (2) Kujdestari posaçërisht është i detyruar, me ndihmën e Organit të Kujdestarisë, të shfrytëzojë të gjitha mjetet e domosdoshme të ndihmës sociale me qëllim që të sigurohen të gjitha kërkesat materiale të nevojshme për zbatimin e masave të caktuara të kujdestarisë."

²² Neni 14.3, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

²³ Neni 14.2, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

²⁴ Procedura e pajtimit mund të zgjatet në qoftë se bashkëshortët pajtohen që të vazhdohet një procedurë e tillë pas skadimit të afatit kohor. Neni 83, Ligji mbi Familjen.

OSBE-ja ka monitoruar raste kur QPS-të nuk kanë qenë ekspeditiv në dorëzimin e raporteve me shkrim të kërkuara nga gjykata brenda afateve ligjore, duke vonuar kështu procedurën civile. Për shembull:

Me 31 janar 2008, në një gjykatë në rajonin e Pejë/Peç paditësi kishte ngritur një kërkesë për shpërbërjen e martesës për shkak të përkeqësimit serioz të marrëdhënieve bashkëshortore. Gjykata, nëpërmjet një parashtrëse me shkrim transferon procedurën e pajtimit tek organi i kujdestarisë me 31 janar 2008. Më 12 qershor 2008, QPS-ja i kishte dorëzuar gjykatës raportin mbi pajtimin ku thuhej se pajtimi kishte dështuar sepse QPS-ja nuk ka mundur të kontaktojë të paditurin i cili banonte jashtë vendit. Raporti i QPS-së arriti gjashtë muaj pas marrjes së kërkesës nga gjykata, duke shkaktuar vonesa të konsiderueshme në procedurat gjyqësore.

Me 9 qershor 2009, në një gjykatë në rajonin e Prizrenit, paditësja parashtroi kërkesë për shkurorëzim për shkak të dhunës së dyshuar fizike dhe mendore që ajo dhe tre fëmijët e saj (një prej të cilëve i mitur) ka vuajtur nga i padituri. Me 30 qershor 2009, në seancë të shqyrtimit kryesor gjykata vendosi të kërkojë nga QSP-ja një procedurë të pajtimit dhe u kërkoi atyre që të japin një mendim lidhur me kujdestarinë e fëmijëve. Pesë muaj më vonë, me 2 dhjetor 2009, u zhvillua seanca e radhës. Gjatë seancës, kryetari i kolegjit deklaroi se vonesa ishte rezultat i drejtpërdrejtë i përgjigjjes së vonuar të QPS-së, që arriti me 9 nëntor 2009. Ligji mbi Procedurën Kontestimore i vitit 2008 parasheh se "shqyrtimi kryesor nuk mund të shtyhet për një kohë të pacaktuar" dhe më tej specifikon se "shqyrtimi kryesor nuk mund të shtyhet për më shumë se 30 ditë, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me ligj."²⁵ Fakti se gjykatës ju është dashur të presë pesë muaj përpara marrjes së raportit të QPS-së që qoi në shtyrje për caktimin e seancës së re është një shembull i qartë se si dështimi për të vepruar nga ana e QPS-së pati ndikim të drejtpërdrejtë në kohëzgjatjen e procedurës. Veç kësaj, pavarësisht nga kjo vonesë, gjykata dështoi të gjobisë QPS-në për dështimin për të paraqitur raportin brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) vuri në dukje se KEDNj vendos ndaj autoriteteve "detyrimin që të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në atë mënyrë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin secilin nga kushtet e tij"²⁶ dhe ripohoi se "Konventa thekson rëndësinë e administrimit të drejtësisë pa vonesa të cilat mund të rrezikojnë efikasitetin dhe besueshmërinë e tij."²⁷ Në shembujt e mësipërm, pavarësisht nga afatet e qarta ligjore, gjykatat morën raportet e ekspertëve nga QPS-të vetëm pas vonesave të mëdha. GjEDNj ka theksuar se nuk është me rëndësi se cilit autoritet dytësor kombëtar i atribuohet kjo shkelje; prapë është autoriteti primar përgjegjës për sigurimin e kësaj të drejte."²⁸ Periudhat e pasivitetit të zgjatur nga ana e autoriteteve relevante është shkelje e të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme.

²⁵ Neni 441 paragrafi 1 dhe 2, Ligji mbi Procedurën Kontestimore i vitit 2008.

²⁶ *Salesi kundër Italisë*, aktgjykimi i 26 shkurtit 1993, Seritë A Nr. 257-E, faqe 60, paragrafi 24.

²⁷ *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, aktgjykimi i 27 tetorit 1994, Seritë A nr. 293-B, faqe 39, paragrafi 61. Shih gjithashtu, *H. kundër Francës*, Aplikacioni Nr. 10073/82, Aktgjykimi i 24 tetorit 1989, paragrafi 58.

²⁸ *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, Aplikacioni Nr. 8737/79, Aktgjykimi i 13 korrikut 1983, paragrafi 32.

Prandaj, dështimi i gjykatave për të kërkuar me kohë ekspertizë nga QPS-ja, ose dështimi i QPS-së për të ofruar ekspertizë brenda afatit të duhur, kanë zgjatur procedurat duke ndikuar kështu në të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme.

OSBE më tej nënvizon se, sipas ligjit, në rastet kur ekspertët dështojnë të parashtrojnë raporte me shkrim brenda periudhave të parapara kohore, pa ndonjë arsye të justifikueshme, gjykata mund të gjobisë ekspertët.²⁹ Megjithatë, deri me sot, OSBE nuk ka monitoruar ndonjë rast kur një QPS është gjobitur bazuar në këtë dispozitë.

Korniza ligjore e Kosovës kërkon që mendimi i ekspertit të QPS-së të jetë pjesë e mbrojtjes procedurale të tij i projektuar për të ofruar kujdes dhe mbrojtje speciale për fëmijët e përfshirë në procedurat civile. Andaj, çfarëdo vonese në shqyrtimin e vlerësimit të bërë nga eksperti i QPS-së, jo vetëm që ndikon në të drejtat e fëmijëve por edhe në të drejtat e personave tjerë që kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejtë në procedurë. Këto vonesa të panevojshme mund të përkeqësojnë barrën me lëndë civile edhe ashtu të madhe në gjykata duke paraqitur pengesë për aftësinë e gjykatës që të gjykojë rastet e reja brenda kohës së paraparë.

Konfuzioni lidhur me rolin e QPS-së

Roli i QPS-së në procedurat civile është thelbësor në mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës. Në çështjet që janë nën kompetencë të gjykatave civile, QPS-ja është e kufizuar me ligj të ofrojë vetëm mendimin e ekspertëve dhe rekomandimet. Megjithatë, OSBE ka monitoruar raste kur gjatë procedurës civile, palët, përfaqësuesit e tyre ligjor, dhe QPS-të kanë shprehur konfuzion sa i përket rolit dhe përgjegjësisë të QPS-së. Për më tepër, në këto raste nuk kishte asnjë ndërhyrje nga gjykata për sqarimin e funksioneve të QPS-së. Për shembull:

Në një gjykatë në rajonin e Prizrenit paditësja kërkoi kujdestarinë e fëmijës së mitur si dhe alimentacion. Paditësja kërkoi nga gjykata për të marrë mendimin e QPS-së. Kërkesa u mbështet edhe nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit. Megjithatë, gjatë një seance të mbajtur me 21 tetor 2009, përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit deklaroi se QPS-ja kishte vendosur se kujdestaria e fëmijës duhet t'i takoj të paditurit, të atit. Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit deklaroi më tej se vendimi i QPS-së ka rregulluar kontaktet në mes të nënës dhe fëmijës. Është e qartë se ka pasur konfuzion sa i përket rolit të QPS-së. Sipas ligjit, në rastet kur prindërit janë të ndarë dhe nuk mund të pajtohen se me kë do të jetojë fëmija, është gjykata ajo që vendosë se ku fëmija duhet të jetojë e jo QPS-ja.³⁰ Ngjashëm, sa i përket mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën në rastet kur fëmija jeton me vetëm një prind apo një person të tretë apo institucion, nëse prindërit nuk mund të arrijnë një marrëveshje, vendimi merret nga gjykata e jo QPS-ja.³¹ QPS-ja nuk është gjykatë, dhe mund të japë vetëm mendim të ekspertit dhe rekomandime për gjykatën.

²⁹ Neni 293.1, Ligji mbi Procedurën Kontestimore i vitit 2008 thotë: “Gjykata mund ta gjobisë deri në 1000 Euro ekspertin i cili pa ndonjë arsye të justifikueshme nuk jap mendimin e vet brenda afatit të paraparë kohor [...]”

³⁰ Neni 139, paragrafi 2, Ligji mbi Familjen.

³¹ Neni 145, Ligji mbi Familjen.

Pavarësisht nga kjo, në rastin e cekur sipër, gjyqtari, nuk ka ndërhyrë për të shpjeguar kompetencën ekskluzive të gjykatës mbi çështjen lëndore.³²

Me 15 gusht 2008, në një gjykatë në rajonin e Pejë/Peć paditësja kishte ngritur një padi për shpërbërjen e martesës. Të dyja palët kanë jetuar jashtë vendit dhe kishin dy fëmijë të mitur që jetojnë në Kosovë me gjyshin. Me 17 tetor 2008, gjyshi parashtrori një kërkesë pranë QPS-së që të ia besoj fëmijët atij. QPS-ja lëshoi një vendim me 22 tetor 2008, përmes të cilit e caktoi gjyshin si kujdestar. Në një seancë të mbajtur më 20 mars 2009, gjykata miratoi propozimin e paditëses për të ia përcjell kërkesën QPS-së për një raport të hollësishëm në lidhje me kushtet e fëmijëve që jetojnë me gjyshin e tyre, si dhe për të verifikuar gjendjen ekonomike-financiare të të paditurit. Megjithatë, përkundër kërkesave të bëra nga gjykata me 11 qershor 2009 dhe 10 shtator 2009, QPS-ja dështojë që të ja dorëzoj gjykatës shkresat e lëndës përkatëse deri me 19 tetor 2009.

Veprimet e QPS-së në këtë rast kanë ngritur shumë çështje në lidhje me kompetencat e saj në krahasim me atë të gjykatës. Së pari, organi i kujdestarisë ka iniciuar dhe ka vendosur lidhur me kujdestarinë e fëmijëve, edhe pse një gjykim për të vendosur këtë çështje ishte në proces pranë gjykatës.³³ Sipas ligjit, QPS-ja duhet të sigurojë vetëm një mendim dhe propozim për gjykatën, pas një kërkesë të bërë nga gjykata.³⁴ Së dyti, ligji parashih se "[p]ërveç në rastin e masave të jashtëzakonshme afatshkurtra, një fëmijë nuk do të hiqet nga kujdesi i prindërve të tij ose prindit, apo personit që kujdeset për të, pa lejen e tyre ose një Urdhër të gjykatës."³⁵ Për më tepër, KDF parashih se autoritetet "[...] do të sigurojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit e tij ose të saj kundër vullnetit të tyre, përveç në raste kur autoritetet kompetente të cilat drejtojnë shqyrtimin gjyqësor përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat në fuqi, që ndarja e tillë është e nevojshme për interesat më të mirë të fëmijës."³⁶ Përkundër këtyre dispozitave të qarta ligjore QPS-ja kishte vendosur mbi kujdestarinë e fëmijëve, dhe gjykata kurrë nuk vuri në pyetje kompetencën e QPS-së për ta bërë këtë. Dështimi i QPS-së për të t'i dorëzuar shkresat në gjykatë gjithashtu shkaktoi vonesa të konsiderueshme në procedurë.

PËRFUNDIM

Ligji parimisht kërkon ekspertizë të QPS-së në rastet ku përfshihen fëmijët. Kur gjykatat dështojnë të kërkojnë këshillën e ekspertëve nga QPS-të në rastet kur mendimi i tyre është qenësor, dhe kur QPS-të dështojnë apo janë neglizhent që t'i përgjigjen kërkesave të gjykatës për ekspertizë brenda afatit të arsyeshëm, rrezikohen interesat më të mirë të fëmijëve që janë të përfshirë në ato procedura. Mund të

³² Neni 11 paragrafi 2 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore i vitit 2008, "[G]jykata duhet të udhëzojë palën e përfaqësuar nga një avokat lidhur me veprimet procedurale, kur konsideron se përfaqësuesi i tij/saj nuk është duke e kryer detyrën e vet në mënyrë profesionale."

³³ Neni 140,1 i Ligjit mbi Familjen thotë se "[...] në kontestet martesore gjykata kompetente sjell vendim mbi shpërbërjen [...] nga ky vendim gjykata vendos edhe për çështjet e kujdestarisë [...]. Ndërsa Neni 140,2 të njëjtit ligj thotë se "[...] gjykata pas dëgjimit të mendimit dhe propozimit të Organit Kujdestar [...] do të vendosë"

³⁴ Neni 14.1 Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare; dhe Neni 140.2, Ligji mbi Familjen.

³⁵ Neni 10.3, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

³⁶ Neni 9, KDF. Shih gjithashtu Nenet 10.1 – 10.15, Ligji mbi Shërbimet Social dhe Familjare.

ndikohen po ashtu edhe të drejtat e individëve tjerë që janë drejtpërdrejtë të përfshirë në procedurë. Gëzimi i të drejtave të palës të përfshirë në të drejtën për gjykim korrekt, në veçanti në të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme, mund të ndikohet negativisht. Për më tepër, konfuzioni lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e QPS-së dhe atë të gjykatës, respektivisht, mund të çojnë në zbatim jo të duhur të ligjit.

Kur funksionon siç parashihet me kornizën ligjore të Kosovës, marrëdhëniet ndërmjet gjykatave dhe QPS-ve duhet të jenë ato të cilat nxisin mbrojtjen dhe promovimin e interesave më të mirë të fëmijëve. Përfshirja e QPS-së në procedurat civile është e projektuar që të funksionojë si masë mbrojtëse për të drejtat e fëmijëve, të cilët janë në mes të anëtarëve më të ndjeshëm të shoqërisë. Kështu, prania e QPS-së dhe ekspertiza janë esenciale jo vetëm për të përmbushur kërkesat e ligjit, por edhe për të siguruar që Kosova përmbush obligimet e veta të parapara me KDF.

REKOMANDIMET

Lidhur me këtë, OSBE rekomandon siç vijon:

- Gjyqtarët duhet ti përmbahen ligjeve relevante dhe brenda afatit të paraparë kohor të parashtrajnë kërkesat për vlerësim të ekspertit të QPS-së, dhe po që se është e nevojshme, edhe pjesëmarrje në seancë;
- Gjyqtarët duhet të sqarojnë rolin dhe funksionin e gjykatës në krahasim me atë të QPS-së, në mënyrë që të shmanget konfuzioni;
- Gjyqtarët duhet të sigurojnë praninë e përfaqësuesve të QPS-së në rastet e dhunës në familje në procedurat ku përfshihen të miturit;
- Gjyqtarët duhet të përdorin autoritetin e tyre ligjor, që nëse është e përshtatshme, të gjobisin QPS-në dhe ekspertët e tyre, për dështimin që të dorëzojnë raportet e shkruara brenda afatit të paraparë kohor;
- Korniza ligjore e Kosovës duhet të jetë e qartë dhe specifike në lidhje me detyrimin e gjykatave për të kërkuar një mendim të ekspertëve dhe/ose të ftojë një përfaqësues nga QPS-ja;
- QPS-të duhet të sigurojnë që puna e tyre të jetë në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës dhe me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti në lidhje me afatet e parashkrimeve ligjore;
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të vazhdojë të trajtojë gjyqtarët aktual dhe kandidatët për gjyqtarë lidhur me ekspertizat e QPS-së, parashkrimet ligjore dhe rolin e tyre në procedurat përkatëse civile.